



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 713 Prot.

Tiranë, më 22.05 2017

VENDIM Nr. 107, datë 17.05.2017

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë (KKA)" (i ndryshuar), si dhe Vendimit Nr. 2, datë 30.01.2009 të KKA "Rregullore mbi Kriteret e Ushtrimit të profesionit të arkeologut; Kriteret e gërmimit, dokumentimit dhe arkivimit të të dhënave dhe materialeve arkeologjike; Kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licencave të ushtrimit të profesionit të arkeologut nga individë dhe subjekte private". Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 8 të datës 17.05.2017, pasi shqyrtoi *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Z. Dhimitër Çondi.*

VENDOSI:

1. Të miratojë *Kërkesën për pajisje me licencë profesionale individuale për veprimtari arkeologjike të tipit "A1" dhe "A2" të Z. Dhimitër Çondi.*
2. Mbështetur në pikën 2, Nenin 11, i Rregullores së sipërpërmendur, subjekti i cili punon në një Institucion Shtetëror, të drejtën e pajisjes me dokumentin e licencës dhe fillimin e efekteve, e ka në momentin e shkëputjes nga puna.
3. Pagesa e *Tarifës së Rregjistrimit* të licencës individuale të arkeologut do të bëhet në momentin e pajisjes me dokumentin e licencës, sipas pikës 2 të sipërpërmendur.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO PURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO